FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION
Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 43 Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.
Tel.Fax: ++381 (0) 38 244 473, mobil:
e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

Prot.Nr:083/2026 **Prishtinë, 07.04.2026**

PROCESVERBAL I TAKIMIT ME KOMISIONET E FSHSK-së

Prishtinë, 07.04.2026
Ora: 16:10
Vendi: Poligoni i Shenjëtarisë – Pallati i Rinisë dhe Sportit, Prishtinë

Data: e punimit te Procesverbalit

Të pranishëm:

- Besim Paqarizi
- Lavdije Raci
- Diellza Lluga
- Arsim Shaqiri
- Fehmi Berisha

Rendi i ditës dhe diskutimet

7. Takim dhe koordinim me Komisionet e Përhershme

U zhvillua diskutim sipas ndarjes organizative:

- **Komisioni i Garave**
  U theksua se organizimi i garave duhet të kalojë në kompetencë të plotë të Komisionit të Garave, ndërsa administrata të ketë rol mbështetës.
- **Komisioni i Referëve**
  U vlerësua puna e deritanishme, duke theksuar se ekziston ende hapësirë për përmirësim dhe ngritje të nivelit profesional.
- **Komisioni i Trajnerëve**
  U diskutua për licencimin e trajnerëve dhe nevojën që klubet të kenë trajnerë të kualifikuar dhe të certifikuar.

- **Komisioni i Sportistëve**
  U theksua rëndësia e përfshirjes së sportistëve në proceset vendimmarrëse dhe aktivitetet e Federatës.
- **Komisioni Femra dhe Sporti**
  U diskutua roli dhe rëndësia e zhvillimit të sportit për femra dhe mbështetja e këtij sektori.
- **Komisioni Mjekësor**
  U theksua rëndësia e mbështetjes mjekësore dhe kontrollit të sportistëve.

8. Takim dhe raportim nga Komisionet Funksionale

- Komisioni Disiplinor
- Komisioni i Ankesave

U diskutua funksionalizimi i tyre dhe trajtimi i rasteve disiplinore dhe procedurale.

9. Takim me Komisionet ad-hoc

- Komisioni për Laureatët 2025
- Komisioni për Intervistim për Nënpunës Administrativ

U diskutua puna e realizuar dhe koordinimi i aktiviteteve në vijim.

10. Plotësimi i standardeve sipas rregulloreve të ISSF 2026

U diskutua:

- përshtatja e pajisjeve sipas kërkesave të reja
- obligimet e sportistëve për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare

11. Të ndryshme

- U diskutua zhvillimi i sportit për të rinj dhe sportit shkollor.
- U theksua nevoja që çdo komision të hartojë plan pune dhe rregullore.
- U propozua shpërblimi financiar prej **30 Euro për medalje**.

VENDIMET NGA TAKIMI ME KOMISIONET

1. Komisionet obligohen të hartojnë dhe dorëzojnë planet e punës për vitin 2026.
2. Komisionet obligohen të hartojnë rregulloret përkatëse.
3. Komisioni i Garave merr përgjegjësi të plotë për organizimin e garave.
4. Të rritet bashkëpunimi ndërmjet komisioneve dhe administratës.
5. Të respektohen standardet e ISSF për pajisje dhe pjesëmarrje.
6. Miratohet në parim shpërblimi prej 30 Euro për medalje.

Procesmbajtësi:
Baki Azemi
Sekretar i Përgjithshëm i FSHSK-së

Kryetari i FSHSK-së
Gëzim Hazrolli